

Drejtuar:

KËSHILLIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FAKULTETIT FILOZOFIK

Në pajtim me nenin 173 të Ligjit të arsimit të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/2018), nenit 32, 34, 35 dhe 36 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurës për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01/4309/2** e datës **01.12.2021**, në bazë të Konkursit për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin shkencor **Letërsi arabe, Tjetër (6.02.02.18, 6.02.02.30** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më **13.03.2026** në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ dhe në web faqen e Universitetit të Tetovës: www.unite.edu.mk, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **24.03.2026**, solli Vendim me nr. **16-187/1** të datës **24.03.2026**, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

1. Prof. dr. Adnan Ismaili - profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës -kryetar,
2. Prof.dr. Ziber Lata, profesor i asociuar në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup - anëtar,
3. Doc.dr. Dritan Skenderi, docent në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës - anëtar.

Duke falënderuar për besimin e dhënë, Komisioni recensues dorëzon këtë:

REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN SHKENCOR LETËRSI ARABE, TJETËR (6.02.02.18, 6.02.02.30 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË PROGRAMIN STUDIMOR FILOLOGJI ORIENTALE TË FAKULTETIT FILOZOFIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin shkencor **Letërsi arabe, Tjetër (6.02.02.18, 6.02.02.30** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Filologji orientale, është paraqitur kandidati: **Dr. Bekim Sulejmani**.

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni recensues jep këto konstatime:

Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidati **Dr. Bekim Sulejmani** është lindur më 18 nëntor të vitit 1977 në Tetovë. Gjatë viteve 1998-2000 me sukses ka kryer kursin e avancuar të gjuhës arabe në Institutin e lartë të gjuhës arabe. Studimet universitare i ka kryer në Universitetin al-Imam në Rijad (Arabia Saudite), në Fakultetin e Thirrjes Islame dhe Komunikimit masiv (2001-2005). Në vitin akademik 2013/2014 ka regjistruar ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale, të cilat i ka përfunduar në mars të vitit 2019, me temë të magistraturës: “*Ibn Mukafa-jeta dhe vepra*”. Në vitin akademik 2020/2021 ka regjistruar studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Shkenca mbi gjuhën, drejtimi: Filologji orientale, të cilat i ka përfunduar më 6 shkurt 2026 me temë disertacioni *Aspektet sociale në Trilogjinë e Kajros të Nexhib Mahfudhit*. Nga viti 2003 është përkthyes gjyqësor për gjuhët arabisht-shqip- arabisht dhe arabisht-maqedonisht- arabisht në rajonin e Gjykatën e Tetovës. Nga tetori i vitit 2011 deri në prill të vitit 2023 ka punuar si mësimdhënës (mualim). Nga viti 2006 ka qënë pjesë aktive e OJQ-ve. Nga viti akademik 2018/2019, kandidati Dr. Bekim Sulejmani ka qënë i angazhuar si asistent i jashtëm në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale. Nga viti 2023 është i punësuar si asistent në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale pikërisht për lëndët nga lëmi i Letërsisë arabe.

I. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Kandidati **Dr. Bekim Sulejmani**, që nga viti akademik 2018/2019 e deri në semestrin veror të këtij viti akademik (2025/2026) ka mbajtur ligjërata (me mbulesë) dhe ushtrime në lëndët: *Arabishtja bashkëkohore I-VIII, Fonetikë dhe fonologji e gjuhës arabe, Morfologji e gjuhës arabe I, Letërsia e vjetër arabe, Letërsia klasike arabe, Letërsia bashkëkohore arabe I-II, Përkthimi i teksteve klasike arabe, Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe* (Fakulteti Filozofik).

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësues-shkencorë, shkencorë, mësues-profesionalë dhe në bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidati **Dr. Bekim Sulejmani** ka realizuar gjithsej **119.25 pikë** nga **veprimtaria mësuese-arsimtare**.

II. Veprimtaria kërkimore-shkencore:

Krahas angazhimit në procesin mësues, kandidati është marrë vazhdimisht me hulumtime shkencore në fushën e letërsisë arabe. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit **Dr. Bekim Sulejmani** përbëhet katër punime të botuar në revista shkencore dhe pjesëmarrje në tubime shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Artikuj shkencorë:

1. *The Views of Ibn al-Muqaffa on Morality and Power in the Works “Al’Adab es- saghir” and “Al-Adab al-Kabīr”*, në: International Journal of Humanities Social Science and Management (IJHSSM), vol. 5, no. 1, 2025.
2. *Naguib Mahfouz – The Voice of Social Conscience in Modern Arabic Literature*, në: International Journal of Humanities Social Science and Management (IJHSSM) v. 5, no. 6, 2025.
3. *The position of the Cairo Trilogy in contemporary Arab literature*, në: PHILOSOPHICA, Volume 12, No. 24-25, ISSN: 1857-9272 (Print), ISSN: 2671-3020 (Online), 178-182.
4. *Comperative analysis of the works of Sami Frasheri (What Albania was, what is and what will become) and Krste P. Misirkov (On Macedonian affairs)*, në: FILOLOGJIA, Vol. 13, No. 24-25, ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012 (Online), 220-226.

Pjesëmarrja në konferenca dhe tubime shkencore:

1. 10-th International scientific conference of Faculty of Philosophy, Universiteti i Tetovës, 16-18 Nëntor 2025.
2. 7-th International scientific conference of Faculty of Philosophy, Universiteti i Tetovës, 15-17 Nëntor 2022 .
3. Seminari XVI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Universiteti i Tetovës, 29-30 shtator, 2022.
4. Simpozium shkencor “*Dialogu mes civilizimeve*”, Orbro (Suedi), 07-09.11.2014.
5. Simpozium shkencor “*Feja në shërbim të shoqërisë*”, organizuar nga Komuna e Oslos dhe Këshilli për bashkëpunim ndërfetar (Oslo), 2011.
6. Trajnim për mësuesdhënësit e mësues-besimtarë, organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, Ohër, 2009.

7. Trajnim për përgatitjen e mësimdhenësve të gjuhës arabe për të huaj, Qendra ndërkombëtare e Mbretit Abdullah bin Abdulaziz, Sarajevë, 05-09.11.2018.
8. Trajnim për mësimdhenësit e gjuhës arabe, AKDEM, Stamboll, 18-24.01.2020.
9. Trajnim për mësimdhenësit e gjuhës arabe, organizuar nga: FOCIC, AKDEM dhe LINGUA STAR, Tetovë, 13-15.01.2023.
10. Trajnim për komunikim në gjuhën arabe për studentët e Ballkanit, organizuar nga: WAMY dhe Universiteti i Tetovës, Tetovë, 03-07.11.2025.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe në bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidati **Dr. Bekim Sulejmani** ka realizuar gjithsej **42.50 pikë** nga **veprimtaria shkencore-hulumtuese**.

III. Veprimtaria profesionale-zbatuese:

Veprimtaria profesionale- zbatuese e kandidatit **Dr. Bekim Sulejmani** përbehet nga një monografi të botuar dhe tri libra të përkthyer nga gjuha arabe në gjuhën shqipe.

Libër nga fusha profesionale:

1. “*Ibn Mukafa- jeta dhe vepra*”, **autor**, monografi, Shkup, 2021.
2. “*Kelilie ve Dimne*“ (pjesa e parë), **përkthyes**, Shkup, 2021 (autor: Ibn Mukafa).
3. “*Kelilie ve Dimne*“ (pjesa e dytë), **përkthyes**, Shkup, 2022 (autor: Ibn Mukafa).
4. “*Endërroj të bëhem një mikser betoni*”, **përkthyes**, Shkup, 2025 (autor: Hussain Mutawaa).

Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit:

“*Ditët e hapura*”, UT, prezantim i programit studimor Filologji orientale 2019-2025.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe në bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidati **Dr. Bekim Sulejmani** ka realizuar gjithsej **23.5 pikë** nga **veprimtaria profesionale-aplikative**.

IV. Veprimtaria me interes të gjerë:

Kandidati **Dr. Bekim Sulejmani** nga viti 2003 është përkthyes gjyqësor për gjuhët arabisht-shqip-arabisht dhe arabisht-maqedonisht- arabisht për rajonin e në Gjykatën e Tetovës. Nga tetori i vitit 2011 deri në prill të vitit 2023 ka punuar si mësimdhënës (mualim) në Tetovë. Ka qenë mentor i studentëve në garat ndërkombëtare të gjuhës arabe në Vjenë, Doha dhe Stamboll.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **Dr. Bekim Sulejmani** ka realizuar gjithsej **35.00 pikë** nga **veprimtaria me interes më të gjerë**.

Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga ana e kandidatit, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-zbatuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati **Dr. Bekim Sulejmani** posedon cilësi shkencore dhe profesionale sipas Ligjit për arsimin e lartë dhe Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, ka grumbulluar **220.25 pikë** nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që janë të nevojshme për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**.

Bazuar në atë që u tha më lart, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, **Dr. Bekim Sulejmani** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** në lëmin **Letërsi arabe, Tjetër (6.02.02.18, 6.02.02.30** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Filologji orientale të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës.

KOMISIONI RECENZUES:

1. Prof.dr. Adnan Ismaili - profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Tetovës – kryetar _____
2. Prof.dr. Ziber Lata, profesor i asociuar në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup – anëtar _____
3. Doc.dr. Dritan Skenderi, docent në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës - anëtar. _____

Tetovë, mars 2026

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: **Bekim Sherif Sulejmani**

Institucioni: **Fakulteti Filozofik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Letërsi arabe, Tjetër (6.02.02.18, 6.02.02.30** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR- SHKENCOR –DOCENT

Nr.	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 8,34 Suksesi mesatar në ciklin e dytë: 9,10 Nota mesatare e integruar nga të dy ciklet: 8,72	Po
2	Titulli shkencor - doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: Shkencat humane (6) , fusha shkencore: Gjuhët dhe letërsia (6.02) , nënfusha shkencore: Letërsia (6.02.02) , lëmia shkencore: Letërsi arabe (6.02.02.18), Tjetër (6.02.02.30)	Po
3	Të publikuara së paku 4 (katër) punime shkencore ¹ në publikim shkencor referent në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
3.1	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensionëve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, të cilën do ta përcaktojë Këshilli Kombëtar për Arsimin të Lartë 1. Emri i revistës shkencore: <i>Philosophica - International Journal of Human Sciences</i> 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Ebsco 3. Titulli i punimit: <i>The position of the Cairo Trilogy in contemporary Arab literature</i> 4. Data e publikimit: 2025	Po
3.2	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe të cilat kanë këshill redaktues në të cilin marrin pjesë anëtarë nga së paku tre shtete, me ç'rast numri i anëtarëve nga një vend nuk mund t'i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve	Po

¹ Për kandidatin, i cili ka më tepër se 4 (katër) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues punimet shkencore do t'i përmend, do t'i shënojë dhe vlerësojë me pikë në Formularin 2.

	<p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Filologjia - International Journal of Human Sciences</i></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): 56 anëtarë, 12 vende</p> <p>3. Titulli i punimit: <i>Comperative analysis of the works of Sami Frasheri (What Albania was, what is and what will become) and Krste P. Misirkov (On Macedonian affairs).</i></p> <p>4. Data e publikimit: 2025</p>	
4	<p>Njohja e së paku një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të Universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale të pavarur</p> <p>1. Gjuha e huaj: Angleze</p> <p>2. Emri i dokumentit: Certifikatë</p> <p>3. Dhënësi i dokumentit: Qendra për gjuhë- Universiteti i Tetovës</p> <p>4. Data e dhënies së dokumentit: 05.03. 2026</p>	Po
5	<p>Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësisë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë Universiteti i Tetovës</p> <p>2. Lloji i trajnimit/përvoja/arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë Mësimdhënie</p> <p>3. Periudha e fitimit të shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë 2018-2026</p>	Po

FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Bekim Sherif Sulejmani**

Institucioni: **Fakulteti Filozofik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Letërsi arabe, Tjetër (6.02.02.18, 6.02.02.30 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	Pikët
1	Mbajtja e ligjëratave (cikli i parë i studimeve)					39.6
1.1	Arabishtja bashkëkohore I (Filologji orientale)	0.04	2	15	2	2.4
1.2	Arabishtja bashkëkohore II (Filologji orientale)	0.04	2	15	2	2.4
1.3	Arabishtja bashkëkohore III (Filologji orientale)	0.04	1	15	3	1.8
1.4	Arabishtja bashkëkohore IV (Filologji orientale)	0.04	1	15	3	1.8
1.5	Letërsi e vjetër arabe (Filologji orientale)	0.04	2	15	4	4.8
1.6	Letërsi klasike arabe (Filologji orientale)	0.04	2	15	4	4.8
1.7	Letërsi bashkëkohore arabe I (Filologji orientale)	0.04	2	15	4	4.8
1.8	Letërsi bashkëkohore arabe II (Filologji orientale)	0.04	2	15	4	4.8
1.9	Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe (Fil. ori)	0.04	2	15	5	6.0
1.10	Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe (Fil. ori)	0.04	2	15	5	6.0
2	Mbajtja e ushtrimeve (cikli i parë i studimeve)					79.65
2.1	Arabishtja bashkëkohore I (Filologji orientale)	0.03	2	15	2	1.8
2.2	Arabishtja bashkëkohore II (Filologji orientale)	0.03	2	15	2	1.8
2.3	Arabishtja bashkëkohore III (Filologji orientale)	0.03	3	15	3	4.05
2.4	Arabishtja bashkëkohore IV (Filologji orientale)	0.03	3	15	3	4.05
2.5	Arabishtja bashkëkohore V (Filologji orientale)	0.03	3	15	8	10.8
2.6	Arabishtja bashkëkohore VI (Filologji orientale)	0.03	3	15	8	10.8
2.7	Arabishtja bashkëkohore VII (Filologji orientale)	0.03	3	15	8	10.8
2.8	Arabishtja bashkëkohore VIII (Filologji orientale)	0.03	3	15	8	10.8
2.9	Letërsi e vjetër arabe (Filologji orientale)	0.03	1	15	4	1.8
2.10	Letërsi klasike arabe (Filologji orientale)	0.03	1	15	4	1.8
2.11	Letërsi bashkëkohore arabe I (Filologji orientale)	0.03	2	15	2	3.6
2.12	Letërsi bashkëkohore arabe II (Filologji orientale)	0.03	2	15	2	3.6
2.13	Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe (Fil. ori)	0.03	1	15	5	2.25
2.14	Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe (Fil. ori)	0.03	2	15	5	4.50
2.15	Fonetikë e gjuhës arabe (Filologji orientale)	0.03	2	15	2	1.8
2.16	Morfologji e gjuhës arabe (Filologji orientale)	0.03	2	15	2	1.8
2.17	Metodika e mësimimit të gjuhës arabe I (Fil. ori)	0.03	2	15	2	1.8
2.18	Metodika e mësimimit të gjuhës arabe II (Fil. ori)	0.03	2	15	2	1.8
Gjithsej (1+2)						119.25

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Teza të mbrojtura	12
1.1	„Aspektet sociale në Trilogjinë e Kajros të Nexhib Mahfudhit“, teza e mbrojtur e doktoratës, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Tetovës, 2026.	8
1.2	„Ibn Mukaffa- jeta dhe vepra“, teza e mbrojtur e magjistraturës, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Tetovës, 2018	4
2	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale	20.5
2.1	Bekim Sulejmani , <i>The Views of Ibn al-Muqaffa on Morality and Power in the Works “Al’Adab es- saghir” and “Al-Adab al-Kabir”</i> , në: International Journal of Humanities Social Science and Management (IJHSSM) Volume 5, Issue 1, 2025.	6
2.2	Bekim Sulejmani , <i>Naguib Mahfouz – The Voice of Social Conscience in Modern Arabic Literature</i> , në: International Journal of Humanities Social Science and Management (IJHSSM) Volume 5, Issue 6, 2025.	6
2.3	Bekim Sulejmani , <i>The position of the Cairo Trilogy in contemporary Arab literature</i> , në: PHILOSOPHICA, Volume 12, No. 24-25, ISSN: 1857-9272 (Print), ISSN: 2671-3020 (Online), 178-182.	6
2.4	Zejni Mazllami & Bekim Sulejmani , <i>Comperative analysis of the works of Sami Frasheri (What Albania was, what is and what will become) and Krste P. Misirkov (On Macedonian affairs)</i> , në: FILOLOGJIA, Vol. 13, No. 24-25, ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012 (Online), 220-226.	4.5
3	Pjesëmarrje në takim shkencor / profesional me prezantim oral	6
3.1	Certifikatë për pjesëmarrjen në Seminarin e XVI Ndërkombëtar të Albanologjisë, Universiteti i Tetovës, shtator 2022.	2
3.2	Certifikatë për pjesëmarrje në Konferencën e Shtatë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filozofik, Universiteti i Tetovës, nëntor 2022	2
3.3	Certifikatë për pjesëmarrje në Konferencën e Dhjetë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filozofik, Universiteti i Tetovës, nëntor 2025	2
4	Abstrakt i botuar në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare	2
4.1	Bekim Sulejmani, <i>The Views of Ibn al-Muqaffa on Morality and Power in the Works “Al’Adab es- saghir” and “Al-Adab al-Kabir”</i> , Book of Abstract, <i>International Congress on Human, Social Sciences and Arts</i> , University of Tetova, 2025, f. 75.	1
4.2	Bekim Sulejmani, <i>Naguib Mahfouz – The Voice of Social Conscience in Modern Arabic Literature</i> , Book of Abstract, <i>International Congress on Human, Social Sciences and Arts</i> , University of Tetova, 2025, f. 275.	1
Gjithsej (1+2+3+4)		42.50

III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Libra nga fusha profesionale	20.00
1.1	Ibn Mukafa- jeta dhe vepra”, autor , monografi, Shkup, 2021.	8
1.2	“Kelilie ve Dimne“ (pjesa e parë), përkthyes , Shkup, 2021 (autor: Ibn Mukafa).	4
1.3	“Kelilie ve Dimne“ (pjesa e dytë), përkthyes , Shkup, 2022 (autor: Ibn Mukafa).	4
1.4	“Endërroj të bëhem një mikser betoni”, përkthyes , Shkup, 2025 (autor: Hussain Mutawa).	4
2	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit	3.50
2.1	Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Filologji orientale 2019- 2025	0.5x7= 3.5
Gjithsej (1+2)		23.50

IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Anëtar i këshillave dhe shoqatave shkencore/profesionale	35.00
1.1	Përkthyes gjyqësor për gjuhët arabisht-shqip- arabisht dhe arabisht-maqedonisht- arabisht për rajonin e në Gjykatën e Tetovës (2003-2026)	23
1.2	Mësimdhënës në mektebin e Xhamisë së Drenovecit- Tetovë (2011-2023)	12

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË TITULL		Pikë
I.	VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	119.25
II.	VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	42.50
III.	VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE	23.50
IV.	VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	35.00
Gjithsej		220.25

KOMISIONI RECENZUES:

1. Prof.dr. Adnan Ismaili - profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Tetovës - kryetar

2. Prof.dr. Ziber Lata, profesor i asociuar në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup – anëtar

3. Doc.dr. Dritan Skenderi, docent në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës - anëtar.

Tetovë, mars 2026

Drejtuar:

KËSHILLIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FAKULTETIT FILOZOFIK

Në pajtim me nenin 173 të Ligjit të arsimit të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/2018), nenit 32, 34, 35 dhe 36 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurës për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, në bazë të Konkursit për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin shkencor **Gjuhë turke, Tjetër (6.02.01.03, 6.02.01.33** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më **13.03.2026** në gazetatditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ dhe në web faqen e Universitetit të Tetovës: www.unite.edu.mk, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **24.03.2026**, solli Vendim me nr. **16-187/1** të datës **24.03.2026**, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

1. Prof. dr. Abdulla Hamiti (kryetar) – profesor ordinar në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (në pension),
2. Prof. dr. Sulejman Baki (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës,
3. Prof. dr. Sejhan Murtezan- Ibrahimimi (anëtar) – profesor inordinar në Fakultetin e Edukimit të Universitetit Ndërkombëtar Ballkanik

REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË FUSHËN SHKENCORE GJUHË DHE LETËRSI, NË NFUSHËN SHKENCORE GJUHËSI DHE LËMIN SHKENCOR GJUHË TURKE, TJETËR (6.02.01.03, 6.02.01.33 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË PROGRAMIN STUDIMOR FILOLOGJI ORIENTALE TË FAKULTETIT FILOZOFIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin shkencor **Gjuhë turke, Tjetër (6.02.01.03, 6.02.01.33** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), është paraqitur kandidati **Dr. Eljesa Ismaili**.

Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidati **Dr. Eljesa Ismaili** është lindur më 29 gusht të vitit 1972 në Kumanovë. Studimet deridiplomike i ka kryer në Universitetin e Ankarasë (Turqi), në Fakultetin Teologjik. Studimet pasdiplomike i ka kryer në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale, drejtimi: Gjuhë dhe letërsi turke. Në vitin akademik 2020/2021 ka regjistruar studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Shkenca mbi gjuhën, drejtimi: Filologji orientale, të cilat i ka përfunduar në prill të vitit 2024 me temë të disertacionit *Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe te folmet turke në Kumanovë me rrethinë*. Gjatë periudhës së viteve 2009-2015 ka punuar si mësimdhënës në Medresenë “Isa Beu”-Shkup. Nga viti akademik 2014/2015, Dr. Eljesa Ismaili ka qënë i angazhuar si asistent part-time në Universitetin e Tetovës, kurse nga viti 2023 është i punësuar si asistent në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale.

I. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Kandidati **Dr. Eljesa Ismaili**, që nga viti akademik 2014/2015 e deri në semestrin veror të këtij viti akademik (2025/2026) ka mbajtur ligjerata dhe ushtrime në lëndët: *Turqishtja bashkëkohore I-VIII, Fonetikë dhe fonologji e gjuhës turke, Morfologji e gjuhës turke I-II, Morfosintaksë e gjuhës turke, Sintaksë e gjuhës turke I-II, Dialektologji e gjuhës turke I-II, Metodikë e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë turke I-II, Leksikologji dhe frazeologji e gjuhës turke, etj.*

Nga viti 2016/2017 ka udhëhequr/mentoruar realizimin e pjesën praktike në lëndën *Metodikë e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë turke II*. Gjatë gjithë kësaj periudhe ka treguar përkushtim, disiplinë.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe në bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidati **Dr. Eljesa Ismaili** ka realizuar gjithsej **162.95 pikë** nga **veprimtaria mësimore-arsimore**.

II. Veprimtaria kërkimore-shkencore:

Veprimtaria kërkimore-shkencore e kandidatit Dr. Eljesa Ismaili pëbëhet nga punime shkencore të botuara në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca nga fusha e turkologjisë.

Artikuj shkencorë:

1. Eljesa Ismaili, *Struktura e veprës së Fuzuliut "Lejla dhe Mexhnun" dhe estetika e të shprehurit*, në: Studime Albanologjike, nr. 22, ISSN: 1857-6958 (Print), ITSHKSH, 2022, 265-270.
2. Eljesa Ismaili, *Lejla e Mehmet Akif Ersojit*, në: VIZIONE, nr. 36, ISSN: 1409-8962 (Print), ISSN: 1857-9221 (Online), 53-61.
3. Eljesa Ismaili, *The influence of the Turkish language on albanian dialects in Macedonia*, në: PHILOSOPHICA, Volume 12, No. 24-25, ISSN: 1857-9272 (Print), ISSN: 2671-3020 (Online), 183-186.
4. Ziber Lata & Eljesa Ismaili, *The linguistic features of the Qur'an in the Arabic language*, në: PHILOSOPHICA, Volume 12, No. 24-25, ISSN: 1857-9272 (Print), ISSN: 2671-3020 (Online), 169-177.

Pjesëmarrja në Konferenca dhe tubime shkencore:

1. 10-th International scientific conference of Faculty of Philosophy ISCFPH 25 Universiteti i Tetovës, 16-18 Nëntor 2025.
2. 1-th Balkan Turkology Workshop, New York University, Tirana 26 June 2025.
3. 21 Dhjetori- Dita e arsimit turk, Universiteti i Tetovës, 18 nëntor 2025.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe në bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. 01-4309/2 e datës 01.12.2021, kandidati **Dr. Eljesa Ismaili** ka realizuar gjithsej **41.50 pikë** nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

III. Veprimtaria profesionale-zbatuese:

Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit:

“Ditët e hapura”, UT, prezantim i programit studimor Filologji orientale 2015-2025.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe në bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. 01-4309/2 e datës 01.12.2021, kandidati **Dr. Eljesa Ismaili** ka realizuar gjithsej **5.50 pikë** nga veprimtaria profesionale-aplikative.

IV. Veprimtaria me interes të gjerë:

Gjatë periudhes së viteve 2009-2015 ka punuar si mësimdhenës në Medresenë “Isa Beu”- Shkup. Është nismëtar dhe kordionator i rrjetit të shoqatave joqeveritare në Kumanovë “Horizont” (2018-2026). Ka përkthyer nga gjuha turke dhe përgatitur për botim dhjetëra tekste që janë botuar në shtypin ditor dhe periodik në gjuhën shqipe dhe turke në Maqedoni.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe në bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. 01-4309/2 e datës 01.12.2021, kandidati **Dr. Eljesa Ismaili** ka realizuar gjithsej **14.00** pikë nga veprimtaria me interes të gjerë.

Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga ana e kandidatit, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-zbatuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati **Dr. Eljesa Ismaili** posedon cilësi shkencore dhe profesionale sipas Ligjit për arsimin e lartë dhe Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, ka grumbulluar **223.45 pikë** nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që janë të nevojshme për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**.

Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t’i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, **Dr. Eljesa Ismaili** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** në lëmin **Gjuhë turke, Tjetër** (6.02.01.03, 6.02.01.33 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Filologji orientale të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës.

KOMISIONI RECENSUES:

Prof. dr. Abdulla Hamiti (kryetar) – profesor ordinar në Fakultetin e
Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (në pension)

Prof. dr. Sulejman Baki (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin
Filozofik të Universitetit të Tetovës,

Prof. dr. Sejhan Murtezan Ibrahimimi (anëtar) – profesor inordinar në
Fakultetin e Edukimit të Universitetit Ndërkombëtar Ballkanik

Tetovë, mars 2026

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: **Eljesa Hamza Ismaili**

Institucioni: **Fakulteti Filozofik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Gjuhë turke, Tjetër (6.02.01.03, 6.02.01.33** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR- SHKENCOR –DOCENT

Nr.	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 8,80 Suksesi mesatar në ciklin e dytë: 9,75 Nota mesatare e integruar nga të dy ciklet: 9,25	Po
2	Titulli shkencor - doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: Shkencat humane (6) , fusha shkencore: Gjuhët dhe letërsia (6.02) , nënfusha shkencore: Gjuhësia (6.02.01) , lëmia shkencore: Gjuhë turke (6.02.01.03), Tjetër (6.02.01.33)	Po
3	Të publikuara së paku 4 (katër) punime shkencore ¹ në publikim shkencor referent në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
3.1	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, të cilën do ta përcaktojë Këshilli Kombëtar për Arsimin të Lartë 1. Emri i revistës shkencore: VIZIONE 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Ebsco 3. Titulli i punimit: Lejla e Mehmet Akif Ersojit 4. Data e publikimit: 2021	Po
3.2	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe të cilat kanë këshill redaktues në të cilin marrin pjesë	Po

¹ Për kandidatin, i cili ka më tepër se 4 (katër) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues punimet shkencore do t'i përmend, do t'i shënojë dhe vlerësojë me pikë në Formularin 2.

	<p>anëtarë nga së paku tre shtete, me ç'rast numri i anëtarëve nga një vend nuk mund t'i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: PHILOSOPHICA</p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): 52 anëtarë, 12 vende/shtete.</p> <p>3. Titulli i punimit: <i>The influence of the Turkish language on albanian dialects in Macedonia</i></p> <p>4. Data e publikimit: 2025</p>	
4	<p>Njohja e së paku një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të Universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale të pavarur</p> <p>1. Gjuha e huaj: Angleze</p> <p>2. Emri i dokumentit: Certifikatë</p> <p>3. Dhënësi i dokumentit: Qendra për gjuhë- Universiteti i Tetovës</p> <p>4. Data e dhënies së dokumentit: 05.03. 2026</p>	Po
5	<p>Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësisë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë Universiteti i Tetovës</p> <p>2. Lloji i trajnimit/përvoja/arsimimi për fitim</p> <p>3. in e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë Mësimdhënie</p> <p>3. Periudha e fitimit të shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë 2014-2026</p>	Po

FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Eljesa Hamza Ismaili**

Institucioni: **Fakulteti Filozofik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Gjuhë turke, Tjetër (6.02.01.03, 6.02.01.33 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	Pikët
1	Mbajtja e ligjëratave (cikli i parë i studimeve)					86.4
1.1	Fonetikë dhe fonologji e gjuhës turke (Fil. orient)	0.04	2	15	12	14.4
1.2	Morfologjia e gjuhës turke I (Filologji orientale)	0.04	2	15	12	14.4
1.3	Morfologji e gjuhës turke II (Filologji orientale)	0.04	2	15	12	14.4
1.4	Morfosintaksë e gjuhës turke (Filologji orientale)	0.04	2	15	12	14.4
1.5	Metodikë e mësimit të gjuhës turke I (Fil. orient)	0.04	2	15	12	14.4
1.6	Metodikë e mësimit të gjuhës turke II (Fil. orient)	0.04	2	15	12	14.4
2	Mbajtja e ushtrimeve (cikli i parë i studimeve)					76.05
2.1	Fonetikë dhe fonologji e gjuhës turke (Fil. orient)	0.03	2	15	12	10.8
2.2	Morfologjia e gjuhës turke I (Filologji orientale)	0.03	2	15	12	10.8
2.3	Morfologji e gjuhës turke II (Filologji orientale)	0.03	2	15	12	10.8
2.4	Morfosintaksë e gjuhës turke (Filologji orientale)	0.03	2	15	12	10.8
2.5	Sintaksë e gjuhës turke I (Filologji orientale)	0.03	2	15	4	3.6
2.6	Sintaksë e gjuhës turke II (Filologji orientale)	0.03	2	15	4	3.6
2.7	Dialektologji e gjuhës turke I (Filologji orientale)	0.03	2	15	6	5.4
2.8	Dialektologji e gjuhës turke II (Filologji orientale)	0.03	2	15	6	5.4
2.9	Metodikë e mësimit të gjuhës turke II (Fil. orient)	0.03	2	15	12	10.8
2.10	Letërsi bashkëkohore turke (Filologji orientale)	0.03	2	15	3	2.7
2.11	Leksikologji dhe frazeologji e gjuhës turke (F.O)	0.03	1	15	2	1.35
Gjithsej (1+2)						162.45

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Teza të mbrojtura	12
1.1	„Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe te folmet turke në Kumanovë me rrethinë“, teza e mbrojtur e doktoratës, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Tetovës, 2024.	8
1.2	„Fonologjia, morfologjia dhe sintaksa në të folmen turke të Kumanovës“, teza e mbrojtur e magjistraturës, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Tetovës.	4
2	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale	12
2.1	Eljesa Ismaili, Struktura e veprës së Fuzuliut “Lejla dhe Mexhnun” dhe estetika e të	6

	<i>shprehurit</i> , në: Studime Albanologjike 22, ISSN: 1857-6958 (Print).	
2.2	Eljesa Ismaili , <i>Lejla e Mehmet Akif Ersojit</i> , në: VIZIONE, nr. 36, ISSN: 1409-8962 (Print), ISSN: 1857-9221 (Online).	6
2.3	Eljesa Ismaili , <i>The influence of the Turkish language on albanian dialects in Macedonia</i> , në: PHILOSOPHICA, Volume 12, No. 24-25, ISSN: 1857-9272 (Print), ISSN: 2671-3020 (Online), 183-186.	6
2.4	Ziber Lata & Eljesa Ismaili , <i>The linguistic features of the Qur'an in the Arabic language</i> , në: PHILOSOPHICA, Volume 12, No. 24-25, ISSN: 1857-9272 (Print), ISSN: 2671-3020 (Online), 169-177.	4.5
3	Pjesëmarrje në takim shkencor / profesional me prezantim oral	2
3.1	Certifikatë për pjesëmarrje në Konferencën e Dhjetë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filozofik, Universiteti i Tetovës, nëntor 2025	2
3.2	Certifikatë për pjesëmarrje në Punëtorinë e parë të Turkologjisë në Ballkan, Tiranë, 26 qershor 2025.	2
3.3	Certifikatë për pjesëmarrje në Simpoziumin shkencor Turqishtja dhe arsimin turk në Maqedoninë e Veriut sot dhe nesër, Universiteti i Tetovës, 18 dhjetor 2025	2
4	Abstrakt i botuar në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare	1
4.1	Eljesa Ismaili, <i>The Grammar of Turkish Language of Hazim Shabanovic</i> , in: Book of Abstract, <i>International Congress on Human, Social Sciences and Arts</i> , University of Tetova, 2025, f. 276.	1
Gjithsej (1+2+3+4)		41.5

III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit	5.5
1.1	Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Filologji orientale 2015- 2025	0.5x11= 5.5
Gjithsej (1+2)		5.5

IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Anëtar i këshillave dhe shoqatave shkencore/profesionale	14
1.1	Mësimdhenës në Medresenë “Isa Beu”- Shkup (2009-2015)	6
1.2	Koordinator i rrjetit të shoqatave joqeveritare në Kumanovë “Horizont” (2018-2026).	8

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË TITULL		Pikë
I.	VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	162.45
II.	VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	37.5
III.	VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE	5.5
IV.	VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	14
Gjithsej		223.45

KOMISIONI RECENSUES:

Prof. dr. Abdulla Hamiti (kryetar) – profesor ordinar në Fakultetin e
Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (në pension)

Prof. dr. Sulejman Baki (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin
Filozofik të Universitetit të Tetovës,

Prof. dr. Sejhan Murtezan Ibrahimimi (anëtar) – profesor inordinar në
Fakultetin e Edukimit të Universitetit Ndërkombëtar Ballkanik

Tetovë, mars 2026